



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih
Poslova / Ministry of Internal Affairs
INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION



HCDF

Në bashkëpunim me Projektin KSV 019
Asistenca Teknike në kontekst të Integritimit
implementuar nga ZKM dhe financuar nga
Qeveria e Luksemburgut

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) mbështetur nga Projekti 'KSV/019 Asistenca Teknike në Kontekst të Integritimit Evropian të Kosovës' bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) - Nr. 13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnimin e trajnerëve, të aplikojnë për ligjërues/trajnerë të ardhshëm për zbatim të këtij programi:

Trajnim për Trajnerë (TpT): Për Partneritet Publiko-Privat

Programi do të përfshijë pjesën teorike dhe praktike lidhur me kornizën ndërkombëtare dhe vendore me fokus në legjislacionin e Kosovës, legjislacionin dhe standardet e BE-së për koncesionet duke përfshirë aftësitë e nevojshme për dizajnimin, kontraktimin, menaxhimin, dhe monitorimin efektiv të projekteve të zbatuara përmes partneritetit publiko-privat.

Qëllimi i këtij programi është që të rritë kapacitetet e zyrtarëve dhe të krijoj nga ta një grup trajnerësh të cilët do të mund të bartin njohuritë të zyrtarët e institucioneve publike në lidhje me implementimin efektiv të Partneritetit Publiko-Privat në ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës publike. Kandidatët që kalojnë me sukses programin e trajnimit, do të certifikohen në mënyrë që të mund të ofrojnë trajnime në këtë fushë.

Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit:

Programi i trajnimit për trajner do të zgjasë katër ditë. Pjesa e parë e trajnimit, konkretisht trajnimi për trajner, tentativisht do të mbahet në javën e dytë të muajit Nëntor.

Vlerësimi i kandidatëve:

Në harmoni me Udhëzimin administrativ të lartcekur, të gjithë kandidatët për trajnerë do të vlerësohen gjatë përzgjedhjes dhe pas përfundimit të trajnimit. Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional;
- Përvoja e punës në fushën adekuatë;

- Përvoja në ofrimin e trajnimeve;
- Elementet tjera të meritës duke përfshirë hulumtimet dhe përvoja në fushën përkatëse.

Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:

Aplikantët që do të rezultojnë të suksesshëm dhe në bashkëpunim me IKAP-in do të mund angazhohen si trajner në kuadër të trajnimeve të ofruara nga IKAP.

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve është nga **19 tetor 2022 deri më 02 nëntor, 2022**. Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm **CV (formati Europass)** dhe një letër motivimi (**deri në 250 fjalë,**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe, në email adresën: Besart.Mulaj@rks-gov.net , duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në Aplikacionin tuaj mund të kërkohen për verifikim.